

Programi suedez i vaksinimeve

PJESA E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË FËMIJËT

Të gjithë fëmijët në Suedi kanë të drejtë vaksinimi kundër nëntë sëmundjeve serioze përmes Shëndetësisë për fëmijë dhe Shëndetësisë shkollore.

Pos kësaj, disa fëmijëve iu ofrohet vaksinimi kundër hepatitit B, tuberkulozës, gripit dhe infeksionit të pneumokokeve (lexo fletën e veçantë të informacionit).

Mosha	Viti shkollor	Vaksinim kundër	Doza
3 muaj		difteri, tetanos, kollë e mirë, poliomielit, Hib, pneumokoke	doza 1
5 muaj		difteri, tetanos, kollë e mirë, poliomielit, Hib, pneumokoke	doza 2
12 muaj		difteri, tetanos, kollë e mirë, poliomielit, Hib, pneumokoke	doza 3
18 muaj		fruth, shyta dhe rubeola	doza 1
5-6 vjeç		difteri, tetanos, kollë e mirë dhe poliomielit	doza 4
6-8 vjeç	1-2	fruthi, shytat dhe rubeola	doza 2
14-16 vjeç	8-9	difteri, tetanos dhe kollë e mirë,	doza 5

Përkujdesja shëndetësore e fëmijëve
 Shëndetësia shkollore

Për fëmijë të cilët kanë lindur deri në vitin 2001 zbatohet një orar tjetër

Mosha	Viti shkollor	Vaksinim kundër	Doza
5-6 vjeç		poliomielit	doza 4
10 vjeç	4	difteri, tetanos dhe kollë e mirë	doza 4
12 vjeç	6	fruth, shyta dhe rubeola	doza 2

Çka dot të thotë vaksinim?

Vaksinim do të thotë që i shtohen trupit pjesë të substancës që e shkakton një sëmundje, apo tërë substanca në formë të dobësuar. Sasia nuk mjafton të krijojë sëmundje, por mjafton që të krijohet një mbrojtje. Nëse njeriut i ekspozohet infeksionit më vonë, imuniteti i trupit është i aktivizuar paraprakisht dhe mund ta bëjë të padëmshëm substancën infektive para se të përhapet sëmundja. Vaksinimi bëhet përmes injektimit me shiringë.

Përparësitë me vaksinimin janë mbrojtjet nga sëmundjet dhe nga pasojat e tyre.

Efektet negative të vaksinimeve janë shqetësimet në lidhje me vetë vaksinimin dhe rreziku nga efektet anësore. Nuk ka masa medicinale që janë krejt të lira nga rreziqet. Megjithatë, Drejtoria kombëtare për shëndet dhe mirëqenie vlerëson se rreziqet nga sëmundjet janë shumë më të mëdha se sa ata të vaksinimeve.

Vaksinimi nuk është i detyrueshëm, por je ti si prind që vendos nëse fëmija yt do të vaksinohet. Kujdesu t'i mbash mend vaksinimet e fëmijës tënd përmes kartelës së Qendrës për shëndetin e fëmijëve (BVC) ose në mënyra tjera.

Çfarë mbrojtjeje të jep vaksinimi?

Vaksinimi nuk garanton që të gjithë që vaksinohen do të jenë të mbrojtur. Ato fëmijë që nuk kanë mbrojtje nga vaksinimet janë edhe ashtu të mbrojtur deri diku nëpërmjet faktit se pothuajse të gjithë fëmijët në Suedi vaksinohen. Një infeksion eventuale, ndërprehet shpejt pasi që shumica e fëmijëve kanë një mbrojtje funksionale.

Vaksinimi në moshën 3 dhe 5 muajsh kundër difterisë, tetanosit, kollës së mirë, poliomielit, Hib-infeksionit dhe infeksionit me pneumokoke japin bashkarisht një mbrojtje themelore. Vaksinimi tjetër që jepet në moshën 12 muajshe, është një dozë përtëritëse që e zgjat kohën e mbrojtjes. Doza tjera përtëritëse kundër poliomielit, difterisë, tetanosit dhe kollës së mirë jepen më vonë. Ndërkaq, kundër Hib-it dhe pneumokokeve nuk kërkohet ndonjë vaksinim shtesë.

Një dozë nga vakcina e kombinuar kundër fruthit, shytave dhe rubeolës jep një mbrojtje të mirë. Një dozë tjetër jepet më vonë një herë në shkollë, pjesërisht për t'i gjetur ata që nuk kanë krijuar mbrojtje nga vakcina e parë, por edhe me qëllim që të sigurohet një mbrojtje afatgjate.

Cilat sëmundje përfshihen në program?

DIFTERIA është një sëmundje shumë ngjitëse dhe një infeksion serioz i fytit që mund të shkaktojë ngulfatje tek fëmijët. Bakterja e difterisë është helm që mund të shkaktojë dëmtime fatale, pos tjerash, në zemër, në veshkë dhe në sistemet nervore.

TETANOSI shkaktohet nga një bakterie që gjindet në truall dhe mund të infektojë plagë. Bakteria prodhon një helm të fortë që shkakton ngërçe të vështira dhe paralizime të frymëmarrjes që shpesh herë përfundojnë me vdekje. Sëmundja nuk është ngjitëse. Ajo nuk mund të mbartet mes njerëzve.

KOLLA E MIRË, është një infeksion i bronkeve shumë ngjites me sulme të kollitjeve të vështira që mund të zgjasin me muaj me radhë dhe që shkaktojnë pneumoni. Për foshnjat, sëmundja mund të jetë shumë e mundimshme dhe madje edhe vdekjeprurëse.

POLIOMIELITI është një sëmundje virusale që përhapet nëpërmjet ujrave të zeza dhe të ujit të ndotur. Dikur, shumë njerëz kanë vdekur ose janë paralizuar ose janë dëmtuar përjetësisht në Suedi si pasojë e poliomielitit. Poliomielitit tani gjendet vetëm në disa shtete në Afrikë dhe Azi.

Hib është një bakterie që mund të shkaktojë infeksione serioze dhe me zhvillim të shpejtë, sidomos tek fëmijët e moshës nën 5 vjeçe. Rreziku për përfundim vdekjeprues gjatë pezmatimit të cipës së trurit dhe helmimit të gjakut është pesë deri më dhjetë përqind dhe ata që mbijetojnë mund të mbeten me pasoja të përhershme si shurdhim dhe sulme të ngërçeve.

PNEUMOKOKET janë bakterje që mund të shkaktojnë infeksione të lehta si infeksione të veshëve dhe të sinuseve, por mund të shkaktojnë poashtu edhe sëmundje shumë serioze, në disa raste edhe vdekjepruese si janë helmimi i gjakut dhe pezmatimi i cipës së trurit. Ka edhe rreziqe për ndërlikime, p. sh. dëmtime të dëgjimit ose forma të ndryshme të dëmtimeve trunore. Vaksina jep një mbrojtje kundër shtatë llojeve të pneumokokeve që tani janë të rëndomta tek fëmijët e vegjël, gjë që është baraz me një mbrojtje rreth 70 përqind.

FRUTHI është një sëmundje virusale shumë ngjitëse dhe zakonisht e mundimshme me temperaturë të lartë, kollitje dhe me puçurra që kruhen. Fruthi mund të shpjerë sëmundje anësore si pezmatimi i cipës së trurit, otiti, dhe pneumonia. Nuk ekziston ndonjë trajtim kundër kësaj sëmundjeje dhe raste vdekjeje ndodhin tek fëmijë që nuk janë vaksinuar.

SHYTAT është një sëmundje virusale që i ndikon gjëndrat pështymore dhe sistemin nervor qendror. Një sëmundje anësore e zakonshme është pezmatimi i cipës së trurit që mund të shkaktojë dëmtime të përhershme të dëgjimit ose shurdhim. Djemtë që sëmuren pas pubertetit mund të preken nga pezmatimi i herdheve që në raste të ralla mund të shkaktojë shterpësi.

RUBEOLA që si rregull është një sëmundje virusale e butë për fëmijë dhe të rritur, por në rast se një grua shtatzënë sëmuret, përbëhen rreziqe të dëmtimeve serioze për trurin, zemrën, shikimin dhe dëgjimin e embrionit.

Cilat vakcina përfshihen në program?

- Kundër difterisë, tetanosit, kollës së mirë, poliomielitit dhe Hib- infeksionit jepen vakcina të kombinuara të ndryshme.
- Vaksina kundër fruthit, shytave dhe rubeolës jepet si një vaksinë e kombinuar.
- Kundër infeksionit të pneumokokeve jepet një vaksinë e veçantë.

Vaksina e kombinuar funksionon njësoj sikurse ato të veçantat dhe nuk është dëshmuar se do të ishte më mirë sikur

vakcinat të ndaheshin. Kontaktojeni Shëndetësinë e fëmijëve ose Shëndetësinë shkollore për informacion se cilat vakcina përdoren atje.

Cilat janë efektet anësore?

Tek shumica e fëmijëve nga vaksinimet nuk krijohen efekte anësore ose ka efekte anësore të parëndësishme. Efektet e mundshme anësore kalojnë zakonisht pas disa ditëve. Në rast se dyshoni ose në rast se fëmija ndjehet keq, ju duhet të kontaktoni me Shëndetësinë e fëmijëve, Shëndetësinë shkollore ose me Shëndetësinë e përgjithshme.

Vaksinimi kundër difterisë, tetanosit, kollës së mirë, poliomielitit, Hib dhe pneumokoket

TË RËNDOMTA (vërehet tek të paktën 1 nga 100 të vaksinuar): kuqe, ënjtje dhe dhembje aty ky është injektuar shiringa, hellre: zjarmi e lehtë, diarre, vjellje.

TË PAZAKONSHME OSE TË RRALLA (FOSHNJAT): Qarje të pandalueshme gjatë disa orëve, zjarmi 39 °C ose më e lartë, ënjtje/kuqe të përkeqësuar, ngërçe të zjarmisë, dobësim, zverdhje, kurtesh.

TË PAZAKONSHME OSE TË RRALLA (TEK FËMIJËT MË TË MËDHENJ): zjarmi 39 °C ose më e lartë, ënjtje/kuqe të përkeqësuar, reaksione alergjike.

Vaksinimi kundër fruthit, shytave dhe rubeolës

TË RËNDOMTA (vërehet te të paktën 1 nga 100 të vaksinuar): kuqe, ënjtje dhe dhembje aty ky është injektuar shiringa. Një reaksion që ngjan si një kopje e dobësuar e sëmundjeve. Më e zakonshme është zjarmia dhe kurteshi 1–2 javë pas vaksinimit. Fëmijët nuk janë molepsës dhe shqetësimet zhduken zakonisht pas disa ditëve. Pas dozës së dytë të vaksinimit, ky reaksion është më i vogël.

TË PAZAKONSHME OSETË RRALLA: dhimbje të lehtë të përkehshme të nyjeve, ngërçe zjarmie, reaksione alergjike.

Ke mendjen para se të udhëtosh jashtë vendit

Para udhëtimeve jashtë vendit, mundet që duhet shpejtuar ndonjë vaksinë e që kërkohen vakcina tjera. Këshillohu me Shëndetësinë e fëmijëve ose me klinikën e vaksinimeve.

Dëshiron të dishë më tepër?

Kontakto në radhë të parë me Shëndetësinë e fëmijëve ose Shëndetësinë shkollore në rast se fëmija juaj e ka filluar shkollën.

ME RËNDËSI

Para vaksinimeve – Trego në rast se fëmija juaj është elergjik ose në rast se ka reaguar pazakonshëm gjatë vaksinimeve të mëherëshme.

Pas vaksinimeve – Kontaktoni me Shëndetësinë e fëmijëve ose Shëndetësinë shkollore në rast se vëreni diçka të pazakonshme te fëmija juaj gjatë kohëve të fundit.